Avni Ermeni

Olimpiada e 42-të e shahut Baku (AZE)



Baku/Neuchâtel 2016

Mbasi u shkrua historia me rrugëtimin evropian në Reykjavik (Island) vitin e kaluar kjo histori rrumbullakësohet edhe me një rrugëtim të gjatë deri në Baku (Azerbejian)...

Shahistët kosovar për herë të parë në një olimpiadë ...

Olimpiada e 42-të e shahut Baku (AZE)

1-14 shtator 2016

Përmbajtja

Hyrje 4
Shënime para olimpiades 5
Nga Baku... 17
Udhëtimi Basel-Stamboll dhe Prishtinë-Stamboll 18
Një natë në Stamboll 18
Arritja në Baku 19
Takimi i parë me doganjerë Azer 19
Akomodimi i përfaqësueses Kosovare 20
Fillimi historik 21
Portali Kosovar që shkroi për olimpiaden sportks.com 22
44. Lojërat e kosovarve 44
Referi Kosovar 103
Norma për mjeshtër ndërkombëtar 104
Rezultatet komplete 106
Rezultatet individuale 108
Fotografi nga Baku 110
Takimi i dytë me doganjeret Azer 113
Para përfundimt 114
Përfundimi 150
Aneks 152
13 fitoret e para në një olimpiadë 152
Burim informacioni 165

Hyrje

Kemi një situatë ku për shahun kosovar edhe një herë do të shkruhet historia me pjesëmarrjen për herë të parë në një olimpiad dhe si akter i drejtëpërdrejt është jo e drejtë në qoftë se nuk shkruaj për këtë ngjarje të madhe shahu,ashtu nga këndi im edhe në qoftë se nuk botohen asnjëher këto të paktën do të mbeten në dosjen time si shënime me vlerë për mua,si shënime që obligimin tim prej shahisti me pjesëmarrjen në këtë olimpiad përfundimsht e rrumbullakësoj si kontribut për shtetin tim...

Ekipa olimpike e Kosoves

IM Bedri SADIKU, Përparim MAKOLLI, FM Avni ERMENI

FM Afrim FEJZULLAHU

FM Nderim SARACI

Shënime para olimpiades
2 korrik 2016

Në Baku (AZE) do të mbahet olimpiada e 42-të e shahut dhe kombëtarja e Kosovës për herë të parë do të jetë pjesëmarrëse dhe lirisht mund të thuhet se në vitin 2016 për shahun kosovar edhe një herë u shkrua historia. Një pjesëmarrje historike në vetë faktin se për herë të parë mbas pranimit në Fide jemi aty ku e gjithë bota do të jetë pjesëmarrëse.Mbasi u shkrua historia me rrugëtimin evropian në Reykjavik(Island) vitin e kaluar kjo histori rrumbullakësohet edhe me një rrugëtim të gjatë deri në Baku (Azerbejian) dhe kombëtarja e Kosovës do të kryen obligimet e veta ndaj partnerve ndërkombëtar që dy vite më herët e pranuan si anëtare të saj në një familje të madhe të shahut.Kanë mbetur edhe 60 ditë deri te fillimi i olimpiades nga ky shkrim i imi dhe ndoshta është shumë herët të shkruajë për gjasat e ekipes olimpike kosovare në këtë garë mirpo ajo qka është për momentin me rëndësi është pjesëmarrja jonë aty dhe është vetëm një fillim ku mendoj se asnjëher nuk do të ndalët nga gjeneratat e reja që do të mirren me shahun kosovar.

Më duhet të shkruajë se në këtë olimpiad të gjithë e kanë merituar të janë prezent dhe ashtu edhe duhet të jetë,të gjithë që deri me ditën e sotit kontribuan për shahun kosovar për të mirë apo për të keq të gjithë mendoj se e kanë vendin sepse kjo duhet të mbetet në kujtesen

e të gjithve që për herë të parë të janë në delegacionin kosovar,aty ku shahu kosovar shkruan histori me debutimin e saj botëror.Nuk ma merr mendja se duhet të ketë mospajtime për një listë të mundshme sepse merita kanë të gjithë sepse pa ta edhe shahu kosovar nuk do të mbijetonte deri te ky moment madhështor.

Ndoshta jamë edhe shumë optimist për këtë garë se një sukses nuk do të mungoj sepse tash më jemi një ekipë i kompletuar dhe i sprovuar në shumë gara ndërkombëtare dhe gjdo rezultat më poshtë nga lista startuese e ekipeve ma merrë mendja se duhet të jetë mosësukses për kosovaret.E di se do të jetë shumë vështirë për të gjithë ne sepse kemi një situat me plotë emocione sespe do ta prezentojm kombin tonë për herë të parë mirpo të gjithë jemi të vetëdijshëm se kemi forcë dhe potencial për një sukses që shumë shtetet do të befasohen.Dy muaj para fillimit të olimpiades ku ende nuk e dijmë numrin e shtetetve pjesëmarrëse, por ajo qka dijmë është se aty do të kemi shahistë nga gjithë Bota dhe shahistë që janë për shahun botëror kampion dhe deri në ditën e sotit kanë shkruar histori për shahun botëror.Kosova do të jetë aty bashkë me këto shtete e barabart dhe vetë pjesëmarrja jonë në garen e madhe botërore fletë më së miri.

Kosova fillon edhe një rrugëtim të saj ndërkombëtar kësaj here edhe më madhështor dhe ajo qka është me rëndësi për momentin është se të gjithë që mirremi me shah duhet të mburremi mbasi kjo rrugë nuk do të ndalet asnjëher.Detyrimet tona për shahun me këtë përmbledhej i krym dhe në të ardhmën duhet të mendojm vetëm si të bëhemi një ekipë e fortë për rezultate të mëdha që shahun kosovar ta rendisim sa më lartë që është e mundur.

9 korrik 2016

Në bisedat para fillimit të olimpiades ka shumë për të shkruarë mirpo disa gjëra duhet të mbeten sekrete, është ligj i natyres sepse ato mund edhe të interpretohen në mënyra të ndryshme.

Një është e sigurtë se ekipa olimpike është kompletuar nga më të merituarit dhe gjdo koment tjetër është vetëm keqë interpretim.Ajo qka kemi arritur deri në këto momente është shumë me rëndësi që asnjë informat nuk e kemi publikuar nëpër rrjete sociale sepse mësimi që kishim para se të shkoim në Reykajvik ku kishte debate shumë të kota mbas publikimit të listës të gjithë e kemi kuptuar se e gjitha duhet të shkoi në heshtje.Nuk është momenti të debatohet se kush duhet të përfshihet në listë sepse ajo dihet dhe gjdo informacion i tepruar e kemi kuptuar se shkon vetëm në dëm të ekipes kombëtare.Ka kohë që e kam përgatitur edhe webfaqen për ngjarjet në olimpiad mirpo nuk është bërë publike dhe këtë e kam vendosur që ta bëjë publike vetëm në atë momentin kur në adresen zyrtare të organizatorit të publikohen listat e shteteve dhe shahistët e saj.

Shumë pluhur është shkruar për të gjithë ne e sidomos për selektorin e kombëtares një vitë me heret dhe kësaj here jemi shumë më komod mbasi shumë pakë informacione u publikuan,këto që jamë ka i shkruar në këto momente një ditë edhe ndoshta do të botohen(krejt mvarët nga unë) mirpo sot do të mbeten vetëm në arhiven time si ngjarje të shkruara 50 ditë para fillimit të olimpiades.

Kosova është e nderuar ku përveq ekipes kombëtare që për herë të parë luan në një olimpiad e e kemi edhe një refer kosovar dhe sa di unë në historikun e olimpiadeve e kemi pasur vetëm një deri me tani që ka referuar në një olimpiad shahu,kjo në qoftë se nuk gabohem ishte olimpiada e Shkupit ku refer kosovar (atë botë në ish Yugosllavin) ishte Z.Sali Gërguri. Sot kemi referin Burhan Misini ku në një kohë të shkurtë arriti të referoj në disa gara me rëndësi ndërkombëtare dhe një shpërblim i till i erdhi në momentin ku edhe kombëtarja e Kosovës shkruan histori në shahun botëror.

Dje u publikua edhe lista e referve të nominuar dhe ishte kënaqësi e veçant që në mesin e shumë referëve botëror nga Kosova e kemi edhe referin tonë në atë nominim nga ana e Fides.Tjerët nuk e di si e kuptojnë këtë mirpo nga ana ime ishte një mirnjohje kur e lexova dje atë listë zyrtare.

10 korrik 2016

Kur ditët po kalojnë dhe olimpiada po afrohet më duhet të shkruajë edhe një informatë me rëndësi sa i përket delegacionit kosovar që do të janë në Baku.Përveqë ne shahistë që tani më dihet në delegacionin kosovar e kemi edhe kryetarin e federates dhe delegatin në Fide Z.Naim Avdiu që do të jetë pjesëmarrës i kongresit të Fides si përfaqësues kosovar.Ajo qka më shumë është e pakjartë është edhe prezenca e kryemjeshtrit Bullgar Alexander Delqev si trener i ekipes kombëtare !

A duhet apo nuk duhet të jetë në këtë delegacion unë nuk mundem të vendosi mirpo shiquar nga një kënd tjetër mendoj se nuk e ka vendin në postin që disa pretendojn se duhet të jetë.Nuk duhet sepse ekipa jonë nuk është ndonjë kandidat për një vend të lartë në tabelë,ky vendim vetëm qka ndikon poashtu edhe në bugjetin e varfër kosovar,si dhe ajo qka më së shumti do të komentohet është se kryemjeshtri bullgar është edhe shahistë i ekipes kampione « Expikut ».Ky propozim i disave ka quar shumë pluhur për ata që e njohin shahun kosovar dhe mendoj se në listen tonë kjo varijant duhet mos të jetë,ku ekipa olimpike që luan për herë të parë ta ket në përbërjen e saj një trener bullgar.

Unë edhe një herë po themë nuk kamë forcë të vendosi se a duhet apo nuk duhet të jetë mirpo shumë pika negative janë të mbledhura që nuk duhet të jetë dhe mendoj që zyrtaret e federates duhet të shiqojn në rend të parë interesin shtetëror e mandej të vendosin për këtë pikë shumë komplexe dhe shumë motivuese që shahistët tjerë të reagojnë dhe pa dyshim edhe kanë të drejtë.

Kamë informacione se lista është shumë më e gjatë dhe shumë aktivistë shahu do të vijnë shkurtimisht në Baku dhe nuk kamë emra e mbiemra për këtë listë mirpo ashtu siq kërkoj organizatori për aspekte sigurie lista duhet të dërgohet deri me 15 korrik që këtyre përsonave të ju sigurohet viza për hyrje në Azerbejxhan.

16 korrik 2016

Kryengritja e mbremshme ushtarake në Turqi në qytetet e Ankares dhe të Stambollit ishte një preukupim që lidhet drejtëpërdrejt me ekipen kosovare olimpike dhe me olimpiaden.Ashtu siq mendojm që deri në Baku të udhëtojm përmes Stambollit kjo kryengritje puqiste e ushtrisë shumë ndikoj në naten e mbrëmshme ku deri në orët e vona e përcjella drejtëpërdrejt në shumë televizone të huaja.Ajo qka lidhet me olimpiaden është se shumë shtete destinacionin për Azerbejxhan janë të detyruar të udhëtojnë përmes aeroporteve turke dhe dilemat nga kjo ngjarje e papritur për fatë të mirë u zgjidhën shumë shpejtë dhe në ditët në vijim na duhet të shiqojmë dhe të përcjellim këtë situatë shumë të pakëndshme për shumë shahistë.

Mbrëm edhe zyrtarisht përfundoj regjistrimi i ekipeve dhe shumë shpejtë pritet edhe publikimi i zyrtarë i tyre në webfaqen e organizatorit dhe më informaten e aplikimit për viza që edhe zyrtarisht dje u publikua mendoj se gjdo gjë nga ana e organizatorit është e rregulluar me një standart të lartë sa i përket informimit.

Ka intervista nga shumë zyrtarë se kjo olimpiad do të mbahet në mend për nga organizimi dhe deri me sotë duke vizituar adresen zyrtare të tyre gjdo gjë është shumë mirë e detajuar.

7 gusht 2016

Vetëm edhe 25 ditë dhe do të fillonë olimpiada e shahut,sot kur shiqojë kohë pas kohe adresen zyrtare të organizatorit i kemi 175 shtete të regjistruara mirpo jo edhe listën e shahistëve pjesëmarrës.Një lajm jo edhe shahistik është se ekipa e Armenis nuk

do të luaj në olimpiad për qeshtje sigurie dhe është për të ardhur keq për këtë kombëtare sepse ishte ndër kandidatët potencialë për fitimin e vendit të parë. Teritori i okupuar në Gornji-karabah dhe problemet në mes të dy shteteve e pamundësojnë pjesëmarrjen e këtij shteti.Para disa dite e lexova edhe një shkrimë ku shahisti nga Zvicërra Yannick Pelletier mundë të luaj në olimpiadë sepse është lejuar nga ministria e jashtme dhe lista e të padëshiruarve nuk vlenë për këtë shahistë,ku lidhej kryesisht me situaten Armeni-Azerbejxhan ku asë vetë nuk e di se qka ka bërë shahisti Zvicërran që të jetë në listen e zezë.Ne kosovarët jemi tepër « komod » sepse nuk kemi asnjë informatë se a në është lejuar aplikimet për viza dhe nuk kemi asnjë informatë se si do të udhëtojmë deri në Baku.Një komunikim tepër i dobët në mes veti në pragë të një ngjarje të madhe historike për shahun kosovar është për të ardhur keq,mirpo kështu e kemi ne dhe jemi mësuar që ngjarjet e mëdha mos të përjetohen ndryshe dhe të lindin vetëvetiu shumë pyetje.Unë qka di nga ana ime është se do të udhëtoj nga Zvicërra dhe ndryshim nuk do të ketë vetëm se jemi duke pritur që të kordinohemi për një takim në aeroportin e Stambollit që të vazhdojmë të gjithë së bashku rrugën për Baku.

26 gusht 2016

Shumë ngjarje ndodhën nga shkrimi i fundit dhe sot kemi një situatë pakë më të kjartë për udhëtimin e shahistëve kosovar drejt Bakus.Para disa dite të gjitha u rezervuan dhe tashë më e kemi itenerarin e kjartë se nga do të udhëtojm dhe në cilin hotel jemi të vendosur plotë dy javë.Udhëtimi i jonë është i paraparë me daten 31 gusht dhe gjysma e ekipes niset nga aeroporti « Adem Jashari » në Prishtinë kurse dy shahistë që jetojmë jashtë Kosovës po të njejtën ditë nisemi nga Baseli (SUI) që të takohemi në aeroportin e Stambollit « Sabiha Gokcen « diku në orët e mbasdites.Një natë të gjithë së bashku do të qëndrojm në Stamboll(TUR) ku të nesërmen



Azerbaycan Respublikası
Republic of Azerbaijan
ELEKTRON VİZA
ELECTRONIC VISA

AE000081866

Vizanın verilme tarixi / Visa issue date: 24 Aug 2016
Tarixden / Valid from: 25 Aug 2016
Tarixedek etibarlıdır / Valid until: 24 Sep 2016
Vizanın növü / Type of visa: ENTRY
Vizanın kateqoriyası / Category of visa: ORDINARY
Girişlerin sayı / Number of entries: SINGLE
Seferin meqsedi / Purpose of visit: TOURISM
Qalma müddeti / Duration of stay: 30
Vizanı rəsmiləşdirən orqan / Visa issuing authority: MFA
Dəvət edən / Invited by: BAKU CITY CIRCUIT

Şəxsi məlumatlar / Personal information
Soyadı, adı / Surname, given names: ERMENI AVNI
Vətəndaşlığı / Nationality: Switzerland
Doğum tarixi / Date of birth: 26 Mar 1966
Doğum yeri / Place of birth: Switzerland, NEUCHATEL
Cinsi / Sex: Male
Peşə / Profession: WORKER
Müşayiət edən şəxslər / Accompanied by: ---

Səyahət sənədinin məlumatları / Travel document's information
Növü / Type: Ordinary
Nömrəsi / Number: X2250075
Verən orqanın adı / Issuing authority:
Verilmə tarixi / Date of issue: 08 Dec 2011
Etibarlılıq tarixi / Date of expiry: 07 Dec 2021

Qeydlər / Notes:

Elektron viza pasporta yapışdırılmır və sərhəd nəzarət buraxılış məntəqəsindən keçərkən pasportla birgə təqdim olunur. Elektron viza etibarlılıq müddəti ərzində istifadə olunmazsa, o qüvvədən düşür.

Electronic visa is not sticked in passport and must be presented with passport at the border-control post. If the Electronic visa is not used within the period of validity, it becomes invalid.

në mengjezë udhëtojm për Baku (AZE) që edhe një herë të shkruhet historia me pjesëmarrjen tonë historike për herë të parë në një olimpiadë.

Eshtë interesant të përmendi se me udhëzimin e kryetarit të Azerbejgjanit për lehtësimin e vizave kam menduar se të gjitha do të shkoin shumë lehtë sa i përket aplikimit dhe vizave për shahistët

mirpo ajo nuk ndodhi dhe shumë vonesa ndodhën deri te përgjegja definitive. Ishte menduar se kjo do të jetë një punë shumë e lehtë dhe vetem një formalitet nga ai vendim që do ta publikojë në gjuhen angleze ashtu siq ju dërgua të gjitha ambasadave,avijacioneve botërore dhe organizates ndërkombëtare të shahut (FIDE)

Simplification of visa procedures for foreigners arriving for World Chess Olympiad

"Azerbaijan's President Ilham Aliyev signed an order on simplifying the visa procedures for foreigners and stateless persons arriving in the country who will travel to Azerbaijan in connection with the holding of the World Chess Olympiad.

Foreigners and stateless persons, who will travel to Azerbaijan during the World Chess Olympiad, will be able to get visas in the structural divisions of the Azerbaijani Foreign Ministry's consular department in the country's international airports.

The basis for the issuance of visas will be considered a document confirming the accreditation in accordance with the relevant rules of FIDE, and the official invitation of the Operating Committee of the Games. Visas will be issued from 20 August, 2016 to 20 September of 2016.

Ministry of Finance of the Republic of Azerbaijan and Ministry of Foreign Affairs of the Republic of Azerbaijan are tasked to ensure logistics of visa issuance to foreigners at International Airports of the Republic of Azerbaijan.

Azerbaijani Foreign Ministry has been instructed to inform the International Chess Federation (FIDE), the International Civil Aviation Organization (ICAO), International Air Transport Association (IATA) and relevant bodies of foreign countries on the simplification of visa procedures for the persons arriving in Azerbaijan in connection with the Olympiad, ensure the placement of information on the facilitation of visa procedures for the persons arriving in Azerbaijan in connection with the Olympiad on the internet resources of the Ministry, as well as embassies and consulates of Azerbaijan in foreign countries.

The State Migration Service of the Republic of Azerbaijan will inform airlines providing regular public service on the Republic of Azerbaijan route about visa facilitation procedures for entering the Republic of Azerbaijan".

Kjo letër më duket edhe më shumë e komplikoj proceduren dhe për shahistët kosovar e kemi letrën e parë që ju dërgua sekretarit të Federates Kosovare që edhe një herë të dërgohen pasaportat dhe fotografit sepse ato nuk janë me përputhen se ata qka dëshironin

« Dear Mr Burhan,

Thanks for the information and documents. You have resent same photos but as I said they are not correct (bad quality, faded, donot fit to the format). Please resend us URGENTLY the following documents: Photos (in good quality, not faded, faces fully visible looking ahead) for:

Fejzullahu Afrim Ermeni Avni Delchev Aleksander Zenuni Albert

And FULLY scanned passport (in good quality not faded) for: Ermeni Avni »!!!!!!

Kështu u detyruam që edhe një herë të dërgohen të gjitha nga fillimi me një skenim më të kjartë që dyshimet e pabazuara nga autoritetet Azere të janë më bindse.

E kamë ditur se mbiemri im do të jetë shumë problematik për këtë shtet mirpo nuk e kam ditur se sa shumë kanë urrejtje për Armenet dhe këtë shtet.

Politika edhe një herë përzihet me sport dhe kjo do nuk do të shlyhet asnjëher.

Fotoja që e dërgova kësaj here...

Azərbaycan Respublikası Nazirlər
Kabinetinin 2016-cı il 3 may
tarixli 184 nömrəli qərarı ilə
təsdiq edilmişdir
4 nömrəli əlavə

Azərbaycan Respublikasının Xarici İşlər Nazirliyi
Ministry of Foreign Affairs of the Republic of Azerbaijan

Azərbaycan Respublikasının ərazisində viza almaq üçün ərizə-anket
Application form to obtain a visa in the territory of the Republic of Azerbaijan

1. Soyad (pasportda olduğu kimi) / Surname (as in passport) Ermeni		
2. Ad (pasportda olduğu kimi) / Name (as in passport) Avni		
3. Cins / Sex ☑ kişi / male ☐ qadın / female	4. Doğum tarixi (gün, ay, il) / Date of birth (day, month, year) 26.03.1966	5. Doğum yeri (şəhər, ölkə) / Place of birth (city, country) Gjakovë (Kosovë)
6. Vətəndaşlıq / Citizenship Switzerland	7. Vətəndaşlığınız dəyişilibmi? (əgər dəyişilibsə, nə zaman və əvvəlki vətəndaşlığınızı göstərin) / Has your citizenship been changed? (if yes, when and your previous citizenship)	
8. Pasportun seriyası və nömrəsi / Number of passport X2250075	9. Azərbaycan Respublikasında qalma müddəti (gün) / Duration of stay in the Republic of Azerbaijan (days) 1-14. 09.2016	10. Səfərin məqsədi / Purpose of visit CHESS OLYMPIAD
11. Qəbul edən tərəfin (hüquqi və ya fiziki şəxsin) tam adı, ünvanı və telefon nömrəsi / Full name, address and phone number of the receiving party (juridical or physical person) BAKU CHESS OLYMPIAD OPERATING COMMITTEE, 93, Zarifa Aliyeva Street, AZ 1000 Baku, Azerbaijan, (+994 12 599 10 90		
12. Mən təsdiq edirəm ki, ərizə-anketdə göstərilən sualları oxuyub başa düşdüm və düzgün cavab verdim. Anlayıram ki, hər hansı yanlış məlumat nəticəsində mənə viza verilməsindən imtina edilə bilər. / I certify that I have read and understood all the questions in this application and correctly responded to all of them. I understand that any false or misinformation may result in the refusal of visa. İmza və tarix / Signature and date 31.08.2016		

Mendoj se e gjitha kjo sidomos për mua është pakë a shumë e lidhur edhe me situaten politike në Azerbejgjan dhe konfliktin me Armenin dhe mbimeri im ishte pak a shumë i dyshuar sepse vetëm një shkronjë po ta ndërrojmë del se kamë lidhje me shtetin Armen,dhe

pasaporta Zvicërrane e jo ajo Kosovare me siguri kan lindur pyetje te ata që vendosin për viza hyrse.Nuk e di ndoshta edhe gabojë mirpo nga e-maili që është nënvizuar : « *And FULLY scanned passport (in good quality not faded) for: Ermeni Avni* » dyshojë se kishte dyshime në mbiemrin tim.

Sot të gjithë i kemi vizat elekronike dhe historia e vizave ka përfunduar vetëm një javë para udhëtimit për Baku.

Këto ditë është vendosur edhe akomodimi i shahistëv Kosovar dhe ai është hoteli « Park Inn by Radisson » kjo zgjedhje nga ana e organizatorit është bazuar nga forca e ekipes në listën startuese dhe për këtë vendim që nuk ka edhe vërejtje është se organizatori merr përsipër pagesen e hotelit dhe ne jemi vetëm ata që duhet të pajtohemi me këtë vendim i mirë apo i keq ky hotel na ka takuar.

Edhe publikimi i listës së shteteve ishte pakë i vonuar mirpo dy javë para fillimit të olimpiadës në adresen zyrtare i kemi të gjitha shtetet pjesëmarrëse dhe listen e shahistëve të tyre.Kosova u rëndit në mesin artë nga 180 shtete botërore dhe gjdo rezultat më poshtë se nga kjo listë startuese e mar si një dështim.

Title	Capitan	Raiting

Title	Players	Raiting
FM	Fejzullahu Afrim	2298
FM	Ermeni Avni	2270
FM	Saraci Nderim	2313
	Makolli Perparim	2289
IM	Sadiku Bedri	2189

Këtu në këtë listë nga organizatori na mungon kapiteni i ekipes dhe disa ditë më vonë u publikua emri i GM Alexander Delchev si kapiten i ekipes mirpo sipas informatave të fundit ky do të mungojë në delegacionin kosovar dhe selektor e kapiten i ekipes kosovare është FM Afrim Fejzullahu ashtu siq është paraparë shumë më herët nga të gjithë.

Nga Baku...
8 shtator 2016

Kamë menduar se këto shktrime të mia do të fillojnë menjiher nga arritja në qytetin e Bakus mirpo ashtu nuk ndodhi sepse shumë ngjarje ndodhën deri në ditën e sotit që shkrimi im u rëndit në rend

të dytë. Janë shënime në vazhdim ku shkurtimisht do të mundohem të përcjelli te lexuesi ato më interesante që janë kryesisht të përmbledhura nga këndi im.

Udhëtimi Basel-Stamboll dhe Prishtinë-Stamboll

Të gjithë u nisem po të njejtën ditë me datë 31gusht 2016 për në Baku dy nga Zvicërra dhe 5 nga Prishtina që vendë takimi ishte paraparë në Stamboll në aeroportin“ Sabiha Gokcen“ diku në orët e mbasdites.Ne nga Baseli u nisem me kompanin Pegassus një kompani që shumë vite më herët ishte suspenduar për Evropë,udhëtimi ishte pothuajë relativisht i qetë përveq një turbulencë mbi Bosfort në zbritje të tij.Edhe shahistët tjerë nga Prishtina nuk kishin ankesa dhe u takuam mbas një pritje afër dy orë në aeroportë të mbushur përplotë me polic Turk përshkak të siguris së aeroportit.Për mua ishte hera e parë në Stamboll dhe hera e parë që në duar kisha një monedhë turke që nuk ja dija asë vleren.Një natë në një hotel 10 minuta largë aeroportit e rezervuar nga konzulata kosovare në Stamboll mirpo këto 10 minuta i kaluam për një orë e gjysmë përshkak të taksistit që dëshironte të përfitonte nga turistet e huaj.Për qudi taksisti nuk e njihte hotelin ishte arsyetimi i tij,ishte një bised dramatike në fund deri kur insistuam që policia të ndërmjetsoj kur nga ky propozim i yni taksisti u qetsua dhe e pranoj shumën që ishte negocuar në nisje.

Një natë në Stamboll

Naten e kaluam në një hotel me një pritje shumë të mirë dhe heret në mengjezë ishte udhëtimi i paraparë për Baku.Këto 10 minuta i kaluam shumë shpejtë me taksistin më korrektë që hoteli na rezervoj kësaj here.

Arritja në Baku

Me kompanin Azerbejian airlines udhëtuam për Baku me një aeroplanë që pakë a shumë i përngjanë „Easyjet“mirpo i vetmi dallim ishte se këtu e kishim edhe mengjezin nga kompania dhe kafe e çaja pa pagesë.Në Baku mbas tri orë udhëtimi pakë a shumë të lodhshëm më në fund arritëm me kohë ashtu siq ishte edhe parashiquar në bilet me një dallim se zbritëm në një vend ku koha ishte dy orë përpara dhe shumë shumë nxehtë.

Takimi i parë me doganjerë Azer

Dhe ajo qka edhe kisha menduar që nga Zvicërra edhe ndodhi takimi i parë me doganjerët apo policin Azere.Një lehtësim ishte e paraprë që kufirin ta kalojmë gjëja pa pengesa dhe me lehtësira mbasi ishim pjesëmarrës të olimpiades mirpo ajo qka ndodhi me doganjeret nuk i përngjante aspak lehtësirave që të kalohet kufiri.

Shumë minuta dhe pritje të verifikimit të pasaportës ndodhi para një sporteli që ishte e mbuluar me kamera dhe me policë të këtij vendi,dhe pyetjet që filluan të parashtrohen ishin pyetje se nuk kamë shkuar të luaj shah në këtë vendë por si gjdo turist tjetër.E ,kam ditur problemin që e kanë me Armenin dhe e kam ditur se mbiemri im do të jetë i dyshimtë për ta,do të jetë aqë i dyshimtë sa edhe pasaporta e kuqe Zvicërrane.Ishin shumë të quditur se si një person që e mban mbiemrin Ermeni është një musliman,ishin të quditur se si posedoj një vizë turistike që po kjo polici para se të vendoste për mua e kishte verifikuar në detale mbiemrin tim dhe kishte vendosur që të posedoja një vizë të till turistike.I bëra disa foto të reja para kameres së sportelit dhe pyetja e quditshme ishte se nga udhëtova dhe a është hera e parë që jamë në këtë vend.Disa telefonata që i bëri doganjeri në sportel në gjuhen e tyre e ndjeja vehtën si nëpër filma,dhe nga biseda vetëm e

kuptoja se është ka flitet për mua si i dyshuar armen që dëshiron të hy në shtetin azer.Shumë qesharake më dukej e gjithë kjo mirpo nga ana tjetër e kuptoja si siguri e shtetit dhe si një gjë që aqë shumë i urrejn shtetasit Armen.Këtu në kufi e kuptova më së miri se pse ekipa Armene e bojkotoj pjesëmarrjen e vetë në këtë olimpiadë dhe e kuptova se me plotë arsye e bojkotuan këtë shtetë për sigurin e tyre.Shahistët tjerë kosovar pas disa verifikimeve rutinotre e kaluan këtë pengesë ku tek unë ishte diqka më e gjatë por në fund kaluese.Mbas kalimit të kësaj menjiher shumë vullnetarë të olimiades na priten duke udhëzuar për hapat tjerë se qka duhet bërë dhe shoqëruar deri te autobusi enkas i paraparë për pjesëmarrësit.

Akomodimi i përfaqësueses Kosovare

Ishte e paraparë që akomodimi i përfaqësueses kosovare të ishte në Hotel Parkinn dhe më të arritur ndodhi edhe befasia e parë ku dhomat ishin të ndara nga dy shahistë e kundërta e asaj se qka më ishte premtuar dhe kërkuar nga ana ime.E gjitha kjo ndodhi nga një të themi „pshtjellim“me shahistin Delcev që ishte rezervuar një dhomë me emrin e tij dhe kurrsesi recepcionistet nuk dëshironin ta shlyenin nga kjo listë.Do të lindë pyetja pse ky person nuk u shly nga lista kosovare edhe pse shumë më heret e dinim se nuk e ka vendin në ekipen tonë?.Unë vetëm di të themë se ishte e gjitha e bërë qëllimisht mbasi kryetari i federates që nuk figuronte në asnjë listë dhe ishte bashkë me ne,dhe për qudi ishte e parashiquar që më herët të zavendsohej dhe të akomodohej në këtë dhomë. Më duhet të bëjë pyetje se a është e rrugës të akomodohen në rend të parë shahistët apo të kanë përparsi funksionarët?Pse ndodhi kjo mosëmarrveshje që disa ditë më herët e skjarova këtë pyetje me selektorin dhe sekretarin e federates? Këto pyetje edhe tani kur po shkruaj nuk kam

përgjegje dhe asë që do të kamë ndonjiher sepse ajo qka kuptova është se secili në rend të parë e shiqon interesin e vetë e në rend të dytë është interesi i lojës së shahut,që unë e shiqoj këtë nga një kënd tjetër që në rend të parë është shahu dhe që asë që më intereson një fitim i till material.Mbas shumë debateve në mes nesh erdha në një pozitë kur edhe vendosa që të kthehem nga kam ardhur dhe këtë olimpiadë ta shly mirpo ne momentin e fundit kryetari që nuk ishte në asnjë listë për akomodim vendosi ta lëshoj dhomën e vetë që e muar nga Delcevi.Këtu është një fajtor me emër e mbiemër dhe e di shumë mirë këtë por nuk do ta shkruaj këtu sepse le të mbetet në ndërgjegjen e vetë në qoftë se ndonjiher lexohen këto radhë.Më duhet të shkruajë edhe këtë se ne që jetojmë në perendim kemi një shiqim tjetër të gjërave dhe nuk e kemi problemin se si të fitojmë disa euro padrejtësisht sepse ato nuk janë të holla që bëhesh i pasur dhe problemin më të vogël e kemi për para sepse këto janë në rend të dytë nga dallim me njerzit që jetojnë në Kosovë me shumë „dallavera“mundohen të fitojnë të holla dhe për 10 euro janë në gjendje që të bëjn gjdo gjë duke mos menduar fare se dikënd e lëndojn.Si do që ë jetë të gjithë u akomoduam ashtu siq secili dëshironte dhe ishim të gatshëm rrugen historike ta vazhdojmë të gjithë së bashku.

Fillimi historik

Takimi i parë me ekipen nga Kina dhe një fillim i ri historik për shahun kosovar.Këtë takim mungova në ekipen e parë dhe si rezervë u inkuadrua Sadiku.Isha një spektator i thjeshtë gjatë kësaj ngjarje dhe ulur në tribinat e pallatit të kristalt siq e quajnë në Baku vendin ku zhvillohej olimpiada përcjellja nga ekrani takimet e shahistëve kosovar me ekipen kampione Kineze.Këtë takim e humbëm me rezultat maksimal mirpo nuk ishte në pyetje rezultati sa ishte në pyetje ky fillim i

mrekullueshëm i ekipes kombëtare Kosovare në një olimpiad e barabartë me të gjitha shtetet botërore.Më duhet të shkruaj se nga ky fillim historik këtë ditë nga mëngjezi e kalova në aeroportin e Bakus ku shumë orë nga një zyre në tjetër e kërkoja valixhn time që e kisha ndërruar në aeroportin e Stambollit.Shumë e komplikuar ishte biseda me disa zyrtare të aeroportit që kurrsesi nuk kuptoheshim edhe pse e kisha me veti një përkthyes Azer (vullnetar i olimpiades).Vetëm një orë para takimit me ekipen Kineze arrita të kthehem në hotel që duke i harruar të gjitha maltertimet me zyrtaret e valixheve të humbura dhe shumë i relaksuar fillova të përcjellja takimin e parë të kombëtares duke i harruar të gjitha sepse loja e shahut ishte më e fortë se humbja e disa sendeve personale, edhe pse kishte sende me vlerë.

Portali Kosovar që shkroi për olimpiaden sportks.com

Kosova në Olimpiadën botërore të shahut "Baku 2016"

Federata e Shahut e Kosovës për herë të parë në historinë e saj pas pranimit të përkohshëm të saj në Federatën Botërore të Shahut (FIDE), do të marrë pjesë në Olimpiadën e Shahut e cila do të mbahet në Baku të Azerbejxhanit prej datës 01 – 14.09.2016.
Në këtë garë do të udhëtojnë 5 shahistët e përzgjedhur kosovarë :

1. Bedri Sadiku, mjeshtër ndërkombëtar
2. Përparim Makolli, mjeshtër kombëtar
3. Avni Ermeni, FIDE mjeshtër
4. Afrim Fejzullahu, FIDE mjeshtër
5. Nderim Saraçi, FIDE mjeshtër

Këtyre shahistëve do t'i bashkangjiten edhe Nysret Avdiu Kryetar i FSHK, Burhanudin Misini refer në Olimpiadë si dhe Naim Avdiu delegat i FSHK në Kongresin e FIDE i cili do të mbahet gjatë ditëve të garave në të cilën Kosova përfundimisht do të bëhet anëtare me të drejta të plota në FIDE.

Për këtë rast Federata e Shahut e Kosovës me datën 29.08.2016 (e hëne) në ora 11:00 në sallën e konferencave në Shtëpinë e Sporteve, do të mbajë konferencë për media.
Me përshëndetje sportive, Nysret Avdiu, Kryetar i FSHK-së.

Një fitore dhe një disfatë e Kosovës në Olimpiadën e shahut "Baku 2016"

Federata e Shahut e Kosovës për herë të parë në historinë e saj është pjesëmarrëse në Olimpiadën e 42-të botërore të shahut "Baku 2016" . Në këtë garë po marrin pjesë shahistët më të mirë të botës nga 180 shtete. Kosova është duke u përfaqësuar nga 5 shaistë, Bedri Sadiku, mjeshtër ndërkombëtar, Përparim Makolli, mjeshtër kombëtar,Avni Ermeni, FIDE mjeshtër,Afrim Fejzullahu, FIDE mjeshtër dhe Nderim Saraçi, FIDE mjeshtër.

Në dy takime të zhvilluara, Kosova shënoi një fitore dhe pësoi një disafë. Shorti nuk ishte i favorshëm për Kosovën pasi në xhiron e parë ku për kundfërshtar pati Kinaë e cila shënoi fitore me rezultat 4:0. Në xhiron e 2-të, Kosova shënoi fitore bindëse në përballje me Guamin me rezultat 4:0.
Sot në programin e pasdites, Kosova për kundërshtar do ta ketë Përfaqësuesen e Venezueles.
Në Baku pos pesë shahistëve gjenden edhe Nysret Avdiu, kryetar i FSHK, Burhanudin Misini, gjyqtar në Olimpiadë si dhe Naim Avdiu delegat i FSHK në Kongresin e FIDE i cili do të mbahet gjatë ditëve të garave në të cilën Kosova përfundimisht do të bëhet anëtare me të drejta të plota në FIDE.

Dy fitore dhe tri disfata të Përfaqësueses së Kosovës në Olimpiadën e 42-të botërore të shahut Baku 2016

Kombëtarja olimpike kosovare që për herë të parë është pjesëmarrëse në një garë me rëndësi botërore pas pesë xhirove të luajtura ka shënuar dy fitore dhe ka pësuar tri disfata dhe rënditet në mesin e shteteve që kanë tubuar nga 4 pikë.Një ngjarje me rëndësi

për shahun kosovare ku mbas Reykjavikut (ISL) vitin e kaluar në kampionatin ekipor evropian edhe një herë shkruhet historia me prezantimin e shtetit të kosovës për herë të parë në një olimpiadë shahu në Baku të Azerbejxhanit.
Në takimin e xhiros së parë ndaj shtetit të Kines kampione e fundit botërore në olimpiaden ne Troms (NOR) në vitin 2014 në xhirot në vazhdim ekipa olimpike kishte kundërshtar më të dobët dhe me lojërat e treguar shumë lehtë ka mundur që të fitohet të paktën edhe një pikë më shumë,sido që të jetë mbasi është edhe hera e parë dhe të gjithë e dim se në një garë të till është vështirë edhe të kemi një rezultat të lartë ,duhemi që të jemi të kënaqur që edhe shahu kosovar prezentohet me të drejta të barabarta në mesin e 180 shteteve botërore ku shumica e shteteve në përbërjen e vetë kanë shahistë me renome dhe kanë lën gjurmë të pashlyera në shahun botërore.Në këtë olimpiadë kemi kampion botëror dhe pretendent për këtë titull dhe vetë pjesëmarrja e kosovarve në këtë garë për shahun kosovar ka një domethënje të veçant.Shtetet që duhet veçuar që janë pretedente kryesore për tri vendet e para janë :Kina,Ukraina,Rusia,SHBA,India dhe Azerbejxhani dhe në gjashtë xhirot në vazhdim priten takime interesante në mes tyre.
Rezultatet e Kosovarve në pesë xhirot e para :

Xhiroja 1
KOSOVA-KINA 0:4
FM Saraci, Nderim 2337-GM Ding,Liren 2753 0:1
Makolli, Perparim 2289-Yu,Yangyi 2725 0:1
FM Fejzullahu, Afrim 2298-Li,Chao b 2746 0:1
IM Sadiku Bedri 2189-Wei,Yi 2717 0:1
Xhiroja 2
GUAM-KOSOVA 0:4
Mafnas, Peter 2095-FM Saraci, Nderim 2337 0:1
CM Molod, Jonathan 1943 - Makolli, Perparim 2289 0:1
Soriano, Rudolph P. 1787 -FM Ermeni, Avni 2270 0:1
Orio, Rogelio L. 1781 - FM Fejzullahu, Afrim 2298 0:1
Xhiroja 3
VENEZUELA-KOSOVA 4:0

GM Iturrizaga Bonelli, Eduardo(2650)-FM Saraci, Nderim (2337) 1:0
IM Gascon Del Nogal, Jose Rafael (2436) - Makolli, Perparim (2289) 1:0
Palencia Morales, Wilson Guillermo (2378) -FM Ermeni, Avni (2270) 1:0
FM Romero Barreto, Jaime Jose (2245) -FM Fejzullahu, Afrim (2298) 1:0
Xhiroja 4
MEXICO-KOSOVA 3:1
FM Saraci, Nderim (2337)- GM Hernandez Guerrero, Gilberto (2506) ½ - ½
Makolli, Perparim (2289)- IM Capo Vidal, Uriel (2314) 0:1
FM Ermeni, Avni (2270) - FM Cofre Archibold, Nestor (2255) ½ - ½
IM Sadiku, Bedri (2189) -FM Garcia Guerrero, Isaac Antonio (2308) 0:1
Xhiroja 5
PAPUA NEW GUINEA-KOSOVA 0 :4
FM Fancy, Stuart (1995)-FM Saraci, Nderim (2337) 0:1
FM Jones, Rupert (1851)-FM Ermeni, Avni (2270) 0:1
CM Marko, Helmut (1939) - FM Fejzullahu, Afrim (2298) 0:1
Skehan, Craig - IM Sadiku, Bedri (2189) 0:1
Nw xhiron e 6-të Kosova që kundërshtar do ta ketë Libanonin.

Lojërat e shahistëve kosovar
http://avniermeni.ch/databaz
akosovare/ekipa-
olimpike.html

Pas një ditë pushimi takimin e radhë në xhiron e gjashtë ekipa olimpike kosovare takohet me shtetin e Libis dhe të gjithë shahistet kosovar janë të mendimit se në këtë takim pritet një fitore e re duke marrë parasyshe se ekipa nga Libia në disa tabela është e renditur më dobët sipas rejtingë listes.
Në Baku Kosova përveç se prezantohet për herë të parë me shahistët e tyre e kemi edhe referin ndërkombëtar z.Burhan Misini që është i zgjedhur nga Fide në mesin e shumë referëve botëror dhe lirisht

mund të themi se edhe ky prezentim për shahun kosovar është e një rëndësie të veçant, që shahu kosovar ka pritur me vite të tëra .
Duhet përmendur se në Baku ka filluar edhe kongresi i FIDE-së dhe Kosova është pjesëmarrëse për herë të parë me delegatin e saj z. Naim Avdiu dhe në agjenden e saj ku është edhe Kosova,pritet edhe konfirmimi zyrtar nga delegatet që shteti ynë të bëhet anëtare e plotë me të gjitha të drejtat duke pasur edhe të drejtë vote.
Avni Ermeni, Baku 2016

Fitore e Kosovës në Olimpiadën botërore të shahut "Baku 2016", Kosova-Libanoni3:1

Pas një ditë pushimi zyrtar Kombëtarja e Kosovës në olimpiaden e 42-të botërore të shahut sot u takua me ekipen Lebanon ku shënoj edhe një fitore me rëndësi ,kështu mbas gjashtë xhirove rënditet në vendin e 98të nga 180 shtete pjesëmarrëse.Ashtu edhe sië është pritur ndaj një ekipi modest sot në takimin me ekipen Lebanon të gjithë ishim të mendimit se këtë takim duhet fituar,dhe deri në këto momente të gjitha janë duke shkuar sipas planit që me ekipet më të dobëta se ne në tabelen startuese mos të dështojm.Me dy fitore në tabelat një dhe dy dhe dy remizime në tabelat tre dhe të katër rezultati përfundimtar ishte në anën e kosovarve 3:1 dhe ekipa olimpike në gjashtë takimet e para arriti të tubojë 50% të pikëve që mendoj se është një suksesë kur dihet se jemi ekipa që luan për herë të parë në një olimpiadë.Duhet veçuar dhe është me rëndësi se ekipa olimpike në Baku delegacioni dhe shahistët janë të motivuar që nga shteti Azer të rënditen disa vende më lartë nga tabela startuese.Me këtë fitore të sotme mendoj se e kemi merituar që neser të takohemi me ekipen e fortë nga Egjipti ku në të gjitha tabelat janë më të fortë se ne për nga rejtingu ku nuk do të thotë se nuk kemi gjasa për një rezultat të mirë.

Avni Ermeni, mjeshtër FIDE/Kosovë/ Baku 2016

Xhiroja 6-të

Kosova (KOS) - Lebanon (LIB) 3 : 1

FM Saraci, Nderim (2337) - FM El Jawich, Amro (2260) 1:0

Makolli, Perparim (2289) - FM Kassis, Antoine (2142) 1:0

FM Ermeni, Avni (2270) - Asmar, Elie (2026) remi

FM Fejzullahu, Afrim (2289)- CMAbdulaziz,Mahmoud (2123) remi

Në xhiron e 7-të. Kosova takohet me Egjiptin. Takimi fillon në orën 13,00 sipas kohës në Kosovë,

Takimet më interesante të xhiros së 6-të:

1. India (IND) – Hollanda (NED) 2½:1½
2. SHBA (USA) – Ukraina (UKR) 2½:1½
3. Republika Qeke (CZE) – Gjeorgia (GEO) 2:2
4. Greqia (GRE)-Azerbejxhani (AZE) 2:2
5. Kanada (CAN) – Bjellorusia (BLR) 2½:1½
6. Gjermania (GER) – Rusia (RUS) 1:3
7. Kina (CHN) – Argjentina (ARG) 2½:1½

etj

Tabela pas xhiros së 6-të:

1.India 12 (19.0) pikë
2.Shba 11 (18)
3.Hollanda 10 (18)
4.Republika Qeke 10 (16.5)
5.Georgjia 10 (17.0)
6.Kina 10 (17.5)
7.Ukraina 10 (16.5)

8.Kanada 10 (19.0)
9.Rusia 10 (18.5)
10.Letonia 10 (15.5)
98.Kosova 6 (12.0)
107.Shqipëra (11.0)
Të gjitha lojërat fillojnë në ora 15 sipas kohës në Baku që është dy orë përpara se koha në Kosovë,këto lojëra të gjitha transmetohen direkt dhe të interesuarit mundë të përcjellin nga adrersa zyrtare : http://bakuchessolympiad.com/
FM Avni Ermeni/Baku-Azerbejxhan/

Një fitore e madhe e Kosovës në Baku- Kosova-Egjipti 2,5:1,5

Përfaqësuesja e Kosovës në Olimpiadën botërore të shahut „Baku 2016“ në xhiron e 7-të bëri befasi duke e mundur Përfaqësuesen nga Egjypti me rezultat 2.5:1.5.Sikur të shikohet forca e ekipes nga Egjypti që në radhët e veta kishte dy kryemjeshtër dhe dy mjeshtër ndërkombëtar me një mesatare të ekipes 2537 pikë,kjo fitore lirisht mund ta quajmë një fitore e madhe. E di që askush nuk e ka pritur këtë rezultat, mirëpo gjatë zhvillimit të këtij takimi tri orët e para në katër tabelat dukshëm qëndronim më mirë dhe sa vinte e kalonte koha këtë përparsi sidomos në tabelen e parë dhe të tretë të gjithë shikuesit (që ishte një shikueshmëri më e madhe) filluan të mendonin se sot befasia do të ndodhë.
Dhe ashtu edhe ndodhi në fund me fitore në tabelen e parë dhe menjiherë pas disa lëvizjeve edhe në tabelen e tretë dhe përparsia ishte në anën e Përfaqësueses së Kosovës ku vetëm pritej remizimi teorik në tabelen e katërt nga FM Afrim Fejzullahu dhe të shënohet kjo fitore që do të mbahet mend nga të gjithë dashamirët e shahut dhe shahistët që mirren aktiv me këtë lojë. Sot u tregua se se Kosova e meritonte që moti të drejtën të përfaqësohet në arenen botërore dhe kjo u kjo u dëshmua me lojëra të mira dhe rezultate inkurajuese.

Rezultatet individuale me përfaqësuesen nga Egjypti
KOSOVA-EGJIPTI 2,5:1,5
1.FM Nderim Saraçi (2337) – GM Amin Bassem (2661) 1 :0
2.Përparim Makolli (2289)– GM Adly Ahmed (2603) 0:1
3.FM Avni Ermeni (2270) – IM Fawzy Adham (2451) 1:0
4.FM Afrim Fejzullahu (2298)– IM Ameir Moheb (2431) remi
Në XHIRON E 8-të, Kosova takohet me Katarin.

Avni Ermeni, shtator 2016, Baku (Aerberbejxhan/

Referi Kosovar në olimpiaden e 42-të në Baku Z.Burhan Misini

Takimi me përfaqësuesen e Egjiptit në Baku,ku kësaj here bëm senzacion në këtë xhiro duke fituar 2.5 :1.5 dhe është një fitore e madhe e njejtë sikur në Reykjavik kur fituam me ekipen e Belgjikes në kampionatin e parë evropian ekiporë.

Disfatë e Kosovës në përballje me Katarin në Baku

Takimi me Katarin në xhiron e tetë për përfaqësuesen e Kosovës ishte një takim vendimtarë pas fitores ndaj Egjiptit për një plasman të lartë .Mirëpo, shumë shpejtë me humbjen në tabelen e dytë dhe më vonë edhe në të treten gjasat për një barazim dukshëm u zvogluan.Në tri tabelat e para shahistët e Kosovës pësuan disfta, kurse në atë të kar\tërtën ku ishte Mjeshtri ynë ndërkobmëtar ia doli të remizoi dhe kështu Katari ia doli që tgë shënoi fitore ndaj Përfaqësueses së Kosovës me rezultat 3,5:0,5. Me këtë disfatë Kosova renditet në pozitën e 97 në mesin e 180 shteteve sa marrin pjesë në këtë olimpiadë. Kjo mbase mund të konsiderohet deri tashti një plasman i mirë ngase Kosova për herë të parë merrë pjesë në një garë të këtij niveli.

KATARI-KOSOVA 3.5:0.5
1.GM Al-Modiakhi Mohamed(2550)-FM Saraçi Nderim (2337) 1:0
2.GM Al-Sayed,Mohammed (2521)-Makolli Përparim (2289)1:0
3.IM Nezad Husein Aziz (2427)-FM Fejzullahu Afrim (2298) 1:0
4.GM Zhu Chen (2418) –IM Sadiki Bedri (2189) remi

Takimet më të rëndësishme në xhiron e tetë për kreun e tabeles
1.Rusia (RUS)-SHBA (USA) 2:2
2.Georgia (GEO)-Ukraina (UKR) 1:3
3.Angli (ENG)-India(IND) 1.5:2.5
4.Azerbejgjani (AZE)-Letpnia (LAT) 2.5:1.5
5.Kina (CHN)-Hungaria (HUN) 1.5:2.5
6.Franca (FRA)-Gjermania (GER) 3 :1

Tabela pas xhiros së 8-të
1.SHBA 14 Pikë
2.INDIA 14 pikë
3.UKRAINA 14 pikë
4.RUSIA 13 pikë

5.AZERBEJGJANI1 13 pikë
6.NORVEGJIA 13 pikë
7.ANGLIA 12 pikë
8.LATVIA 12 pikë
97.KOSOVA 8 pikë
Etj.

KOSOVA pranohet edhe zyrtarisht në kongresin e 87të të FIDE-së me të drejta të plota.

Shahistët Kosovar që treguan një prezentim të mirë, mbasi është edhe hera e parë deri në këto momente kanë 4 fitore dhe shiquar tabelen momentale gjenden në mesin e ekipeve ku edhe është pritur që nga fillimi.
Ajo qka duhet vequar këtë xhiro është se në tabelen ku shkruante Kosova sot figuronte shenja politike (fusnota) gjë që deri në xhiron e tetë kjo nuk ishte,një intervenim i shteteve jo mike në rend të parë Serbis e shtyri organizatorin që të intervenonte mirpo shahistët Kosovar edhe një herë u treguan se nuk jemi në Baku që të bëjmë skandale politike dhe menodojë se sotë treguam një kulturë më të lartë se shteti i Serbisë.

Naim Avdiu, Nysret Avdiu dhe Bashkim Vatovci në kongres...

PARLAQ ZƏKALAR
DİYARINDA

PARLAQ ZƏKALAR ODLAR DİYARINDA
42-ci Şahmat Olimpiadası
SOCAR
Azercell
LAVAZZA
QATAR

Një përgjegje më e mira sot ndodhi në kongresin e 87të të FIDE-se ku Kosova u pranua me të gjitha të drejtat ndërkombëtare edhe

